

## 1. Si mund të informohem rreth Universitetit tuaj?

Për informacion ju mund të drejtoheni pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” në Rr.Dritan Hoxha, Tiranë.

Zyra e Pranimeve është e disponueshme nga e hëna në të premte, orari 08:00-16:30 dhe ditën e shtunë, orari 08:00-13:00. Gjithashtu mund të na shkruani në adresën: [info@unizkm.al](mailto:info@unizkm.al) ose të na telefononi në numrin: 00355 422 73 290

## 2. Cilat janë programet e studimit që ofron Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”?

### Programet e studimit të Ciklit të parë/ Bachelor:

- Infermieristikë;
- Fizioterapi;
- Ekonomi Ndërmarrjeje;

### Programet e studimit të Ciklit të dytë

- Programe të Integruara “Master i Shkencave”:

- Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në Mjekësi
- Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në Odontoiatri dhe Proteza dentare
- Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në Farmaci
- Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në Arkitekturë

- Programe studimi “Master i Shkencave”:

- Master i Shkencave në “Shkenca Infermieristike dhe Obstetrike”
- Master i Shkencave në “Shkenca Rehabilituese të Profesioneve Shëndetësore”
- Master i Shkencave në “Ekonomi dhe Menaxhim”

### Programet e studimit të Ciklit të tretë

- Doktoratë:

- Doktoratë në “Statistikë”

- Programet e specializimeve afatgjata të fushës së mjekësisë:

- Kirurgji e Përgjithshme (5 vite – 300 ECTS);
- Ortopedi dhe Traumatologji (5 vite – 300 ECTS);
- Mjekësi Trasfuzionale (4 vite – 240 ECTS);
- Gastroenterologji (4 vite – 240 ECTS);
- Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular (4 vite – 240 ECTS);
- Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapia Intensive (5 vite – 300 ECTS);
- Shkenca të Ushqyerit (4 vite – 240 ECTS);
- Gjinekologji dhe Obstetrikë (5 vite – 300 ECTS);
- Kardiochirurgji (5 vite – 300 ECTS);
- Nefrologji (5 vite – 300 ECTS);

### 3. A është i akredituar Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”

Intitucioni është akredituar 3 herë me vlerësim maksimal respektivisht në vitin 2007, 2016 dhe së fundmi në vitin 2017, ku raporti vlerësues i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Akreditimit (QAA), jep vlerësimin pozitiv duke nënvizuar faktin se Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” përmbush plotësisht të gjitha Standardet Shetërore të Cilësisë.

### 4. A njihet diploma që lëshon Universiteti juaj edhe jashtë vendit?

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” lëshon *diploma të përbashkëta* me universitetet italiane partnere:

- Partneri akademik për Fakultetin e Mjekësisë është Universiteti "Tor Vergata" i Romës;
- Partneri akademik për Fakultetin e Farmacisë dhe Fakultetin e Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale është Universiteti i Studimeve të Barit “Aldo Moro”;
- Partneri akademik për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, që ofron programin e integruar të studimit “Master i Shkencave” në Arkitekturë, është Universiteti i Studimeve të Firences. Në përfundim të procesit mësimor lëshohet *Diplomë e dyfishhtë* nga të dy Universitetet partnere.

Programet e studimit që zhvillohen janë të njëjtat me ato që zhvillohen në universitetet partnere. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e vlefshme në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian.

### 5. Sa janë tarifat e studimit për vitin akademik 2020-2021?

Më poshtë gjeni tabelën e tarifave vjetore të shkollimit për vitin akademik 2020-2021 për kandidatë shtetas të Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë, Bosnje-Hercegovinës:

Programi i studimit	Tarifa
Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në Mjekësi	€ 4.765,00
Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në Odontoiatri dhe Proteza Dentare	€ 4.765,00
Programi i studimit në Fizioterapi	€ 2.334,00
Programi i studimit në Inferieristikë	€ 2.334,00

Programi i studimit në Inferieristikë (Elbasan)	€ 1.963,00
Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në Farmaci	€ 4.765,00
Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në Arkitekturë	€ 3.707,00
Programi i studimit në Ekonomi Ndërmarrjeje	€ 2.334,00

## 6. A ofron lehtësime në pagesa apo bursa Universiteti juaj?

Për studentët shtetas të Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Bosnje-Hercegovinës që regjistrohen për herë të parë, në vit të parë, aplikohen bursa studimi në varësi të mesatares së përgjithshme të shkollës së mesme si në tabelën e mëposhtme:

Mjekësi	€ 4.765,00	$9 < M^* < 9,99$	15%
		M = 10	30%
Odontoiatri dhe Proteza Dentare	€ 4.765,00	$9 < M < 9,99$	15%
		M = 10	30%
Farmaci	€ 4.765,00	$9 < M < 9,99$	50%
		M = 10	80%
Fizioterapi	€ 2.334,00	$9 < M < 9,99$	15%
		M = 10	30%
Infermieristikë (Tiranë)	€ 2.334,00	$9 < M < 9,99$	15%
		M = 10	30%

Ekonomi Ndërmarrjeje	€ 2.334,00	9 < M < 9,99	50%
		M = 10	80%
Arkitekturë	€ 3.707,00	9 < M < 9,99	50%
		M = 10	80%
Infermieristikë (Elbasan)	€ 1.963,00	9 < M < 9,99	15%
		M = 10	30%

M\* - Mesatarja e VKM

Studentët, të cilët në çastin e regjistrimit shlyejne gjithë tarifën vjetore të shkollimit në një këst të vetëm, përfitojnë një zbritje prej 5 % të tarifës vjetore.

Për rezultate të larta gjatë karrieres suaj universitare përfitoni bursa merite të përshkallëzuara jo të plota.

## 7. Çfarë ofron kampusi universitar?

Kampusi universitar i Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", selia e Tiranës, ndodhet në Rr. Dritan Hoxha, jo shumë larg qendrës së kryeqytetit.

Kampusi ofron për studentët:

- Kushte bashkëkohore dhe mikpritëse;
- Një hapësirë të lirë dhe të gjelbëruar;
- Një bibliotekë të pasur dhe të përditësuar në të gjitha fushat;
- Mundësi për praktike didaktike pranë:
  - Poliambulancës "At Luigji Monti";
  - Klinikës Universitare të Odontoiatrisë "Zoja e Këshillit të Mirë"
  - Qendrës së Rehabilitimit dhe të Mjekësisë Sportive (QRMS);
- Mundësi për kurse gjuhe pranë Qendrës Universitare të Gjuhëve "Zoja e Këshillit të Mirë"
- Free Wifi;
- Shërbim kancelarie;
- Parking.

## **8. A ekziston mundësia për akomodim në kampusin universitar?**

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” (Tiranë) nuk ofron mundësi akomodimi në konvikt. Për studentët femra që ndjekin studimet në degën e Infermierisë në Elbasan, Universiteti ofron një rezidencë universitare:

<https://www.unizkm.al/posts/slug/universita-cattolica-nostra-signora-del-buon-consiglio-sede-di-elbasan/>

## **9. Jam shumë i interesuar për të studjuar pranë Univeristetit tuaj, por kam pak njohuri në gjuhën italiane. Ofroni kurse gjuhe?**

Qendra Universitare e Gjuhëve "Zoja e Këshillit të Mirë" organizon dhe ofron kurse të gjuhëve të huaja sipas niveleve gjuhësore të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPERGJ) me metoda dhe tekste të përditësuara për mësimdhënien.

Kurset mund të zhvillohen në grup ose individualisht, sipas kërkesat dhe nevojat e studentëve dhe kohëzgjatja e tyre ndryshon në varësi të tipologjisë dhe modalitetit të kursit.

Për më shumë informacion, ju lutemi të konsultoni linkun:

<https://www.unizkm.al/posts/slug/kerkim-shkencor/>

Ose të kontaktoni:

e-mail: [segreteria.cla@unizkm.al](mailto:segreteria.cla@unizkm.al)

tel: +355 44 54 14 20

cel: 069 21 01 756

## **10. Cilët janë kriteret e pranimit për vitin akademik 2020-2021?**

Ju lutemi të konsultoni në linkun e mëposhtëm kriteret e pranimit në programet e Ciklit të I dhe në ato të integruara të Ciklit të II për vitin akademik 2020-2021:

<https://www.unizkm.al/uploads/media/post/0001/01/d6005d127bcb6f5446236fa7801b164ac6c5d8ce.pdf>

## **11. Cilat janë procedurat e aplikimit në UKZKM për vitin akademik 2020-2021?**

Hapat për të aplikuar në UKZKM:

1. Plotësimi i Formularit A1 (Matura 2020) ose A1Z (nëse keni përfunduar arsimin e mesëm përpara vitit 2019-2020) pranë shkollës së mesme;
2. Përzgjedhja e programit/eve të studimit ku dëshironi të regjistrohesh në UKZKM ndër 10 preferencat tuaja në Portalin U-Albania: <https://ualbania.al/>;
3. Testimet e pranimit në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”.

## **12. Nëse nuk e përzgjedh Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” gjatë aplikimit online në Portalin U-Albania, a mund të regjistrohem në Universitetin tuaj?**

Nëse nuk përzgjidhni programin/programet e studimit të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" si preferencë gjatë aplikimit online në Portalin U-Albania nuk mund të merrni pjesë në testimet tona të pranimit e për rrjedhojë nuk mund të regjistroheni në Universitetin tonë.

## **13. A mund të më jepni më shumë informacion rreth testeve të pranimit?**

Testimet e pranimit zhvillohen në gjuhën italiane pranë selisë qendrore të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" Rr. Dritan Hoxha, Tiranë.

- Kandidatët që përzgjedhin në portalin U-Albania programet e studimit në Mjekësi, Odontoiatri dhe Proteza Dentare Infermieristikë apo Fizioterapi kryejnë testimin e pranimit që përfshin:

1. Testim me shkrim në gjuhën italiane, mbi njohuri të përgjithshme të fituara gjatë shkollës së mesme në lëndët si Matematikë, Fizikë, Biologji, Kimi - 30 pikë;
2. Testim mbi njohjen e gjuhës italiane - 20 pikë;
3. Notën mesatare të përgjithshme të shkollës së mesme - 30 pikë;

- Për programin e studimit në Arkitekturë kriteret e pranimit janë:

1. Nota mesatare e përgjithshme të shkollës së mesme - 30 pikë;
2. Njohja e nivelit të gjuhës italiane - 20 pikë;

\* Në rast se numri i aplikimeve të kandidatëve e tejkalon numrin e vendeve në dispozicion, bëhet edhe një testim me shkrim në formën e pyetjeve, në italisht për të vlerësuar njohuritë e përgjithshme të zotëruar nga kandidati.

- Për programin e studimit në Farmaci, kriteret e pranimit janë:

1. Nota mesatare e përgjithshme të shkollës së mesme - 30 pikë;
2. Njohja e nivelit të gjuhës italiane - 20 pikë;

\* Në rast se numri i aplikimeve të kandidatëve e tejkalon numrin e vendeve në dispozicion, bëhet edhe një testim me shkrim në formën e pyetjeve, në italisht për të vlerësuar njohuritë e kandidatëve në Shkenca Natyrore.

- Për programin e studimit në Ekonomi Ndërmarrjeje kriteret e pranimit janë:

1. Nota mesatare e përgjithshme të shkollës së mesme - 30 pikë;
2. Njohja e nivelit të gjuhës italiane - 20 pikë;

## **14. Kur do të zhvillohen testimet e pranimit?**

Datat e zhvillimit të testimeve të pranimit dhe procedurat përkatëse do të publikohen në vijim nëpërmjet thirrjeve për aplikim në faqen zyrtare të Universitetit:  
<https://www.unizkm.al/posts/slug/regjistrim-ne-vitin-e-pare/>

Për t'u njoftuar me e-mail mbi të rejat rreth aplikimit dhe regjistrimit në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", mund të shprehni interesin tuaj duke plotësuar formularin që gjeni në linkun e mëposhtëm:  
<https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSeHOf3beUVsl1XX2hYjiHOMJdQNn6mR4gToPKdUCvEWZoCkZQ/formResponse?entry.238026406=Student+Registration&continue=continue>

### **15. Çfarë roli luajnë lëndët me zgjedhje për t'u pranuar në Universitetin tuaj?**

Përzgjedhja e lëndëve me zgjedhje nuk ndikon në procedurat tona të pranimit sepse kriter pranimi në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" janë kriteret e pranimit të shpjeguara më sipër. (Rezultatet e lëndëve me zgjedhje ndikojnë në llogaritjen e mesatares së përgjithshme të shkollës së mesme).

### **16. A ka program lëndësh apo shembuj testesh për përgatitjen e një maturanti që dëshiron të kryejë testimet e pranimit pranë Universitetit tuaj?**

Nuk ka një program të përcaktuar lëndësh për studim sepse pyetjet mbështeten në njohuritë e përgjithshme që fitohen gjatë shkollës së mesme në lëndë si: Matematika, Fizika, Biologjia dhe Kimia. Për tu pajisur me një model të testimit shkencor që ka rënë në vitet e kaluara mund t'i drejtoheni Zyrës së Pranimeve të Universitetit, e disponueshme nga e hëna në të premte, orari 08:00- 16:30, dhe ditën e shtunë, orari 08:00- 13:00.